



PARANDALIMI: KATALOG TRAJNIMI (Pjesa III)

Përmbajtje

3..... Përmbajtje

4..... Qëllimi i katalogut

6..... Produktet

38..... Fjalor termash

CHANNEL - NDËRGJEGJËSIMI I PËRGJITHSHËM

PARANDALIMI – E-LEARNING (MËSIMI online)

KUNDËRSHTIMI I EKSTREMIZMIT – NARRATIVAT DHE BISEDAT

WORKSHOP MBËSHTETËS ONLINE PËR TË RRITUR NDËRGJEGJËSIMIN E PARANDALIMIT

TRAJNIM PER PARANDALIMIN E RADIKALIZIMIT

TRAJNIM NDËRGJEGJËSUES PËR DETYREN E PARANDALIMIT

TË KUPTUARIT E SHTIGJEVE DREJT EKSTREMIZMIT DHE PROGRAMI PARANDALUES



Qëllimi i katalogut:

1. Ky katalog është prodhuar nga Zyra Kombëtare (Home Office) për të nxjerrë në pah disa nga kurset e trajnimit me akses publik në lidhje me Parandalimin që mund të ndihmojnë individët që përshijnë kriteret e Detyrës së Parandalimit (Prevent Duty), të përfshira në Seksionin 26 të Ligjit Kundër Terrorizmit dhe të Sigurisë 2015. Të gjitha autoritetet e specifikuar që i nënshtrohen Detyrës, do të duhet të sigurojnë ofrimin e trajnimeve të përshtatshme për stafin e përfshirë në zbatimin e Detyrës.

2. Udhëzimi për Detyrën e Parandalimit i publikuar në mars 2015 dhe i disponueshëm në adresën www.gov.uk/government/publications/prevent-duty-guidance ofron informacion të mëtejshëm rreth sfondit të Detyrës. Strategjia e Parandalimit e publikuar në qershor 2011 është e disponueshme në www.gov.uk/government/publications/prevent-strategy-2011.

3. Udhëzimi për Detyrën e Parandalimit e bën të qartë se stafi në vijën e parë që angazhohet me publikun duhet:

- Të kuptojë se çfarë do të thotë **radikalizim** dhe pse njerëzit ndoshta mund të jenë të vulnerabël për t'u tërhequr nga terrorizmi si pasojë e tij.
- Të jetë i vetëdijshëm për atë që nënkuptojnë me termin "**ekstremizëm**" dhe marrëdhëniet mes ekstremizmit dhe terrorizmit.
- Të dijë se cilat masa janë në dispozicion për të parandaluar që njerëzit të tërhiqen në terrorizëm dhe si të sfidojë ideologjinë ekstremiste që mund të lidhet me të.
- Të kuptojë si të sigurojë mbështetje për njerëzit që mund të shfrytëzohen nga ndikimet e radikalizuese.

4. Kurset në kuadër të këtij katalogu synojnë të mbështesin stafin e vijës së parë për rritjen e kuptimit, njohurive dhe ndërgjegjësimin të tyre në këto fusha.

5. Disa produkte brenda këtij katalogu janë në dispozicion pa pagesë. Të tjerë mund të kenë kosto dhe këto kosto janë specifikuar në pasqyrat e kurseve.

6. Ka një sërë kursesh të tjera që janë gjithashtu në dispozicion që mund të mos përfshihen në këtë katalog që mund të dëshironi të merrni në konsideratë. Disa prej tyre mund të kenë qëllime më të gjera, për shembull mësimi i aftësive të të menduarit kritik për studentët. Disa kurse të



mirënjohura nuk janë aktualisht në dispozicion të publikut dhe prandaj nuk përfshihen në këtë katalog.

7. Home Office synon të prodhojë një katalog të këtij lloji në mënyrë periodike. Ne do të shqyrtojmë dobën e këtij katalogu përpara se të vendosim nëse botimet e mëtejshme të këtij katalogu do të jenë të dobishme.

Procedura:

Kurset e përfshira në katalog duhet:

- Të jenë përgjithësisht në përputhje me politikën e Parandalimit - në termat e koncepteve që u referohen (për shembull, rreth procesit të radikalizimit)
- Të përdorin gjuhën e duhur (për shembull, mënyra më e përshtatshme për të përshkruar kërcënimin terrorist);
- Të vlerësohen si përgjithësisht efektive për qëllimin e synuar të trajnimit për Parandalimin (për shembull, cilësia e materialeve dhe trajnimit); dhe
- Të përmbushin synimet për të mbështetur stafin e vijës së parë në rritjen e kuptimit, njohurive dhe ndërgjegjësimin të tyre në fushat e përmendura në paragrafin 2 (më lart).

9. Home Office do të shqyrtojë kurset e trajnimit për t'i përfshirë në katalog. Përshtatshmëria dhe rëndësia e kurseve do të rishikohet pas çdo reagimi nga ata që kanë ndjekur kurset. Ofruesve të trajnimit mund t'u kërkohet të mbledhin reagimet nga pjesëmarrësit pas zhvillimit të kurseve të trajnimit.

Mohim: Disclaimer

Përderisa Home Office ka bërë përpjekje të arsyeshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e ofruesve të trajnimit, kurse dhe materiale, nuk pranon asnjë detyrim në lidhje me këto kurse. Përveç siç parashikohet shprehimisht, asgjë në këtë katalog nuk ka për qëllim të krijojë ndonjë partneritet, përkatësi, asociacion ose sipërmarrje të përbashkët midis Home Office, ose ndonjë nga organizatat e renditura, të zgjedhë ndonjë organizatë të listuar si agjent i Home Office, ose të autorizojë ndonjë organizatë të listuar për të bërë ose për të hyrë në ndonjë angazhim për ose në emër të Home Office.



PRODUKTE

CHANNEL - NDËRGJEGJËSIMI I PËRGJITHSHËM

Organizues: [Zyra Qendore e Policisë Kombëtare kundër Terrorizmit](#)

Qëllimi:

Të rritet ndërgjegjësimi i procesit të Channel dhe si punon Parandalimi për të ofruar një përgjigje proporcionale, për të mbështetur njerëzit në nevojë brenda hapësirës jo-kriminale.

Channel është një program i cili fokusohet në ofrimin e mbështetjes në një fazë të hershme për njerëzit të cilët janë identifikuar si të prekshëm për t'u tërhequr në terrorizëm. Programi përdor një qasje multi-agjenci për të mbrojtur njerëzit në nevojë duke:

- identifikuar individët në rrezik;
- duke vlerësuar natyrën dhe shtrirjen e këtij rreziku; dhe
- zhvillimin e planit më të përshtatshëm të mbështetjes për individët në fjalë

Audienca e synuar:

Stafi mbrojtës Strategjik dhe ai i Vijës së Parë në të gjitha organizatat e sektorit publik, si policia, shërbimet sociale, shërbimi i provës, arsimit, personeli shëndetësor dhe komunitetet lokale.

Përshkrimi:



Ky modul ofron informacion mbi Channel, detyrat dhe përgjegjësitë brenda procesit. Kursi duhet t'i mundësojë përdoruesit të:

- Kuptojë sesi lidhet Channel me Strategjinë e Qeverisë Kundër Terrorizmit ([CONTEST](#))
- Përshkruajë procesin e Channel dhe qëllimin e tij;
- Identifikojë faktorët që mund t'i bëjnë njerëzit të pambrojtur ndaj radikalizimit; dhe
- Përcaktojë ruajtjen dhe zotërimin e riskut të procesit të Channel.

Metoda e zhvillimit: Platformë online që mundëson e-learning

Gjatësia e produktit:

Përafërsisht 30 minuta.

PARANDALIMI – E-LEARNING (MËSIMI online)

Organizuesi: HMG

Qëllimi:

Për të shpjeguar qëllimin e Parandalimit, procesin e radikalizimit, si të identifikojmë kur dikush mund të jetë i cënueshëm ndaj radikalizimit, si të ngremë shqetësimet dhe si duket një përgjigje proporcionale.

Audienca e synuar:

Stafi i vijës së parë, duke përfshirë policinë, shërbimet sociale, shërbimin e provës, arsimin, stafin shëndetësor dhe komunitetet lokale.

Përshkrim:

HMG ka zhvilluar një produkt Parandalimi, e-Learning (Mësim Online) për të ofruar një prezantim të Parandalimit duke synuar objektivin dy të Strategjisë së Parandalimit - mbështetjen e njerëzve të cënueshëm. Është zhvilluar për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të



shpjeguar Parandalimin brenda kontekstit më të gjerë mbrojtës. Parandalimi-Mësimi Online do të mbështesë trajnimin ekzistues të WRAP.

Përfundimi i **Parandalimit--E-Learning** do të mbështesë përdoruesit për të vënë re shqetësimet që mund t'i bëjnë individët e prekshëm ndaj radikalizimit, si duket një përgjigje proporcionale, si dhe me vetëbesimin dhe aftësinë për të ngritur shqetësime kur dikush mund të jetë në rrezik.

Metoda e zhvillimit:

Platformë online që mundëson e-learning.

Gjatësia e produktit:

Përafërsisht 40 minuta - 1 orë; kohëzgjatja mund të ndryshojë në varësi të qasjes së audiencës në përmbajtje plotësuese, mbështetëse.

Si të aksesoni

<https://elearning.prevent.homeoffice.gov.uk> / or via www.educateagainsthate.com

COUNTER EXTREMISM – NARRATIVES AND CONVERSATIONS KUNDËRSHTIMI I EKSTREMIZMIT – NARRATIVA DHE BISEDAT

Organizuesi: [London Grid for Learning- Rrjeti i Londrës për të Mësuar](#)

-një organizatë bamirëse edukative që ofron broadband të përkushtuar, me shpejtësi të lartë, në shkollat e Londrës, së bashku me shërbimet e rrjetit të menaxhuar dhe burimet mësimore premium.

Qëllimi:

“**KUNDËRSHTIMI I EKSTREMIZMIT – NARRATIVAT DHE BISEDAT**” synon jo vetëm të mbështesë mbrojtjen e të rinjve, por edhe të lehtësojë diskutimin për respektin, tolerancën, kohezionin e komunitetit dhe vlerat e përbashkëta. Ekziston një evidencë në rritje, veçanërisht në internet, për emocionet kundër emigracionit dhe kundër muslimanëve tek komunitetet dhe të rinjtë në Mbretërinë e Bashkuar.

Duke kuptuar narrativën e organizatave ekstremiste, mësuesit dhe profesionistët që punojnë me të rinjtë dhe prindërit e tyre mund të thyejnë më mirë paragjykimet dhe të ndërtojnë ura.



Audienca e synuar:

Përderisa **LGfL** pret që burimi të përdoret kryesisht nga dhe për mësuesit, është e rëndësishme edhe për profesionistët e tjerë. Shkollat mund të zgjedhin të përdorin materiale në mësimet e nivelit të mesëm të qytetarisë, Citizenship & PSHE, për të nxitur debatin dhe diskutimin mbi ekstremizmin dhe / ose vlerat britanike.

Përshkrimi:

LGfL ka krijuar këtë burim video në partneritet me Sara Khan nga Organizata, kundër-ekstremizmit dhe për të drejtat e gruas, **Inspire**. Sara ofron informacione, njohuri dhe këshilla për të ndihmuar shkollat të lundrojnë në këtë zonë të vështirë. Ajo nxjerr në pah faktin se Islami i zakonshëm dhe ISIS janë 2 botë të ndryshme, dhe parashtron parime që të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjitha format e ekstremizmit, duke përfshirë edhe të djathtën ekstreme.

Burimi merr formën e 32 videoklipeve në katër seksione tematike, me pyetje të tilla si

"Përse grupe të caktuara të të rinjve angazhohen me narrativeën e ISIS?",

"Cili është roli i propagandës online në angazhimin e vajzave të reja?" Dhe

"Cili është mesazhi më i rëndësishëm për Islamin që kundërshton pikëpamjen e ISIS?"

Metoda e zhvillimit: Videoklipe të vendosura në Web

Gjatësia e produktit: 32 videoklipe në katër seksione tematike. Kohëzgjatja totale 48 minuta; kohëzgjatja mesatare 1m30. Videot mund të përdoren si burim i vetëm ose si një seri.

Si të aksesoni: counterextremism.lgfl.net

ONLINE FACILITATED WORKSHOP TO RAISE AWARENESS OF PREVENT (WRAP)

WORKSHOP MBËSHTETËS ONLINE PËR TË RRIUR NDËRGJEGJËSIMIN E PARANDALIMIT

Organizuesi: JISC

Përmbajtja e HMG-së është zhvilluar për ofrimin online nga [JISC](http://www.jisc.ac.uk). JISC është organizata jo-fitimprurëse e sektorit të arsimit të lartë dhe të FE në Mbretërinë e Bashkuar për shërbime dhe zgjidhje dixhitale. Ajo operon me infrastrukturën dhe shërbimet dixhitale të përbashkëta,



negocion marrëveshjet sektoriale me shitësit e IT dhe botuesit komercialë dhe ofron këshilla të besueshme dhe ndihmë praktike për universitetet dhe kolegjet dhe ofruesit e trajnimeve. HISC do të shpërndajë WRAP online.

Qëllimi:

Të ndihmojë pjesëmarrësit të identifikojnë kur dikush mund të jetë i prekshëm nga radikalizimi, si të ngrenë shqetësimet dhe si duket një përgjigje proporcionale.

Audienca e synuar:

FE, HE, ofruesit e trajnimeve. Ky trajnim është një workshop i drejtpërdrejtë në internet, me qëllim që WRAP të jetë më i aksesueshëm për individët që nuk janë në gjendje të marrin pjesë në seanca ballë për ballë - për shembull fillestarët, punëtorët e largët, kontraktorët afatshkurtër dhe me kohë të pjesshme dhe menaxhuesit e lartë. Pjesëmarrësit do të kenë një PC ose laptop për të marrë pjesë, dhe do të duhet të kenë njohuri kompjuteri.

Përshkrimi:

Workshopi për Rritjen e Ndërgjegjësimit për Parandalimin (WRAP) është një sesion i fokusuar në raste studimi me video, JISC është porositur të shpërndajë këtë përmbajtje përmes një platforme interaktive online. Workshopi është një hyrje për të parandaluar dhe mbështetur objektivin 2 të Strategjisë së Parandalimit, për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Është ndërtuar për të rritur ndërgjegjësimin për Parandalimin në një mënyrë joalarmuese dhe sinjalizon për mekanizmat më të gjërë mbështetës dhe ruajtjen e iniciativave në dispozicion.

- Workshopi ofron raste studimi mbi individë të ndikuar nga Al Qaeda dhe E Djathta Ekstreme. Tregimet bazohen në perspektivën e njerëzve që kanë kaluar nëpër procesin e Parandalimit, si dhe atyre që kanë bërë referime në Parandalim. Modulet përfshijnë dobësitë, radikalizimin, çfarë të bëjnë, referimet dhe ndërhyrjet. Workshopi përmban ushtrime interaktive për të ndihmuar pjesëmarrësit të identifikojnë shenjat e mundshme të dobësive. Këto ushtrime fokusohen në rastet studimore me rëndësi të veçantë për HE / FE dhe sektorëve të aftësisë.
- Pjesëmarrësit duhet të lënë sesionet e WRAP me aftësinë për të vënë re shqetësimet që mund t'i bëjnë individët të cënueshëm nga radikalizimi, si dhe besimin dhe aftësinë për të ngritur shqetësime kur dikush mund të jetë në rrezik.

Metoda e zhvillimit:



Të udhëhequr nga lehtësues të certifikuar të mësimit online, këto seanca pjesëmarrëse ofrohen në një mjedis mësimi online. Pjesëmarrësit duhet të kenë një desktop apo laptop, shfletues interneti, ose kufje dhe një mikrofon.

Gjatësia e produktit: Workshop-i zgjat rreth 2 orë, në varësi të madhësisë së grupit dhe diskutimit.



PREVENTION OF RADICALISATION TRAINING

TRAJNIM PER PARANDALIMIN E RADIKALIZIMIT

Organizues: [Flick Learning Limited](#)

Flick- është një ofrues i mësimit elektronik me mision për të transformuar botën e trajnimit nga "duhet të bësh" në një përvojë të këndshme, të kënaqshme dhe efektive. Flick beson në mbajtjen e përmbajtjes në përmasa të reduktura, me kuptim, dhe e lehtë. Imazhe mahnitëse. Animacion. Interaktivitet. Muzikë/ Audio. Tregim - me zë profesional.

Qëllimi:

[Kursi i Parandalimit të Radikalizimit të Flick](#) është i dizajnuar në mënyrë specifike për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë se çfarë është radikalizimi, si ndodh dhe kush mund të jetë më i prekshëm ndaj tij. Ai mbulon shenjat dhe treguesit e përbashkët të radikalizimit, pasojat e radikalizimit, si të merreni me shqetësimet tuaja dhe çfarë të bëni nëse dyshoni se një person është duke u radikalizuar. Kursi përfshin gjithashtu një temë mbi ekstremizmin dhe një tjetër mbi strategjinë dhe legjislacionin e qeverisë, duke përfshirë edhe CONTEST, programin e Channel, dhe vetë Detyrën e Parandalimit. Udhëzimi për Detyrën e Parandalimit të sektorit specifik mund të gjendet në rangun e udhëzimeve Quickflick që shoqërojnë kursin.

Audienca e synuar:

Stafi i vijës së parë, duke përfshirë arsimin, shëndetësinë, policinë, shërbimet sociale dhe provës, si dhe të gjithë ata që punojnë ose bëjnë vullnetarizëm me fëmijët dhe të rinjtë dhe / ose të rriturit në rrezik.

Përshkrim:

Kursi përbëhet nga pesë tema të të nxënimit me përmasa të zvogëluara dhe një vlerësim. Është akredituar për CPD nga Shërbimi i Akreditimit i CPD. Certifikatat janë në dispozicion për t'u shkarkuar / printuar pas përfundimit të suksesshëm të kursit. Përveç përmbajtjes së kursit, Flick siguron një sërë burimesh shtesë duke përfshirë:

- Udhëzime Quickflick të sektorit specifik për Detyrën e Parandalimit në shkollat dhe ofruesit e kujdesit për fëmijët, FE, HE, shëndetësinë dhe autoritetet lokale;
- Udhëzuesi Quickflick për ISIS dhe Mediat Sociale; dhe



- Bordi në Pinterest dhe playlista në YouTube që kanë të bëjnë me përmbajtjen e kursit, dhe duke përfshirë artikujt aktualë, tendencat e fundit, raportet e lajmeve dhe statistikave.

Metoda e zhvillimit:

Kursi i mësimit elektronik mund të kryehet në çdo kohë, kudo, duke përdorur çdo pajisje: Flicks është plotësisht i përshtatshëm në PC, tabletë ose telefon.

Gjatësia e produktit : Përafërsisht 1 orë.

PREVENT DUTY AWARENESS TRAINING ®

TRAJNIM NDËRGJEGJËSUES PËR DETYREN E PARANDALIMIT

Organizuesi: [Victvs Ltd](#)

Victvs Ltd është një trajner i specializuar dhe ofrues i mbështetjes për organizatat e prekura nga ekstremizmi dhe radikalizimi dhe Detyra e Parandalimit. Me zyra në qytetin kufitar të Uellsit,



Monmouth, St Johns Wood në Londër dhe Blackburn në Veri Perëndim, VICTVS janë në gjendje të ofrojnë trajnime dhe shërbime të tjera në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar

Qëllimi:

Victvs Ltd. kanë krijuar një varg kursesh trajnimi për t'ju ndihmuar të përmbushni detyrimin tuaj ligjor dhe për të kuptuar më mirë temat komplekse të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.

Nëse keni nevojë për të zhvilluar një kuptim bazë për të përmbushur detyrimin tuaj, ose jeni personi përgjegjës për ruajtjen në një organizatë më të madhe, VICTVS ofron zgjidhje të drejtpërdrejta dhe zgjidhje me trajnime efektive.

Audienca e synuar:

Ky kurs është i dizajnuar për njerëzit që kërkojnë një kuptim të mirë dhe themelor se si Detyra e Parandalimit ndikon në punën e tyre. Është ideale për: mësuesit, edukatorët e hershëm, ofruesit e arsimit të lartë dhe të mëtejshëm, punonjësit e burgjeve dhe të provës, ofruesit e kujdesit për fëmijët, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit e rinisë, organizatat bamirëse dhe ndërmarrjet sociale, autoritetet lokale dhe të tjerët.

Përshkrimi:

Trajnimi (bazik) online, 1 orësh Ndërgjegjësues për Detyrën e Parandalimit do t'ju japë:

- Ndërgjegjësim bazik mbi ekstremizmin dhe radikalizmin, dhe Detyrën e Parandalimit në punën tuaj;
- Rritje të besimit në trajtimin e këtyre çështjeve komplekse;
- Përmbajtja e mësimit e miratuar nga Plain English Campaign;
- Një certifikatë unike e CPD e përfundimit të trajnimit me vlerë 1 orë ndaj totalit tuaj vjetor;
- Hyrje në burimet tona të mësimit; dhe
- Ulje në të gjitha kurset e tjera të trajnimit Victvs Ltd. dhe shërbimet mbështetëse.

Metoda e zhvillimit

Të mësuarit në internet përmes www.victvs.co.uk



Gjatësia e produktit: Përafërsisht 1 orë.

UNDERSTANDING PATHWAYS TO EXTREMISM AND THE PREVENT PROGRAMME

TË KUPTUARIT E SHTIGJEVE DREJT EKSTREMIZMIT DHE PROGRAMI PARANDALUES

Organizuesi:

[Sektori i Shëndetit dhe Kujdesit Social të Kolegjit Virtual](#) punon në bashkëpunim me një numër agjencish ruajtëse dhe organe qeveritare për të zhvilluar dhe ofruar përmbajtje të angazhueshme që kanë një ndikim në sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve në rrezik.

Që nga viti 1995, Virtual College ka zhvilluar dhe ofruar një model bashkëpunues shumë të suksesshëm të të mësuarit elektronik në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, duke lejuar organizatat të trajnojnë një numër më të madh njerëzish sesa është e mundur me trajnime tradicionale ballë për ballë; ofron një qasje të përzier të të mësuarit dhe zhvillimit dhe ofron një mesazh të qëndrueshëm në një audiencë të gjerë me shpejtësi të madhe.

Me mbi 1.9 milion nxënës në të gjithë sektorët publikë dhe privatë, Virtual College vazhdon të punojë me bordet mbrojtëse, organizatat e NHS, shkollat, organizatat bamirëse, bizneset private, policinë dhe qeverinë kombëtare e lokale për të ofruar trajnime mesatarisht për 1,500 nxënës të rinj çdo ditë.

Qëllimi:

Të kuptoni çfarë janë ekstremizmi dhe radikalizimi dhe pse është e rëndësishme të diskutoni dhe adresoni këto;

- Të njihni elementet kryesore lidhëse të Parandalimit dhe të Strategjisë së Qeverisë CONTEST;
- Të kuptoni më mirë se çfarë i bën njerëzit të pambrojtur ndaj radikalizimit; dhe
- Të njihni përgjegjësitë tuaja dhe të njihni indikatorët ku radikalizimi mund të ndodhë.



Audienca e synuar:

Të gjithë profesionistët që punojnë në sektorë ku ata bien në kontakt me njerëz që mund të jenë të ekspozuar ndaj radikalizimit, qofshin të rritur, fëmijë apo të rinj.

Përshkrimi:

Kursi u jep delegatëve një ndërgjegjësim dhe kuptim të procesit të radikalizimit në mënyrë që ata të ndjehen të sigurt për të qenë proaktiv në ndërmarrjen e një qasjeje me shumë-agjenci ndaj ndërhyrjes së hershme dhe mbështetjes.

Plani i Mësimit:

a. Prezantimi:

- Llojet e terrorizmit
- Pse duhet të diskutohen ato

b. Strategjia e Parandalimit:

- Legjislacioni dhe Strategjitë qeveritare
- Parandalimi dhe CONTEST
- Parandalimi dhe Channel

c. Procesi i Radikalizimit:

- Raste studimi
- Vërejtja e shenjave
- Loja me shkallë e gjarpër
- Ushtrime reflektuese dhe sfida

d. Çfarë duhet të bëj?

- Një përgjigje proporcionale
- Përgjegjësitë e mia
- Çfarë informacioni të ndaj dhe si

Një numër ekspertësh të lëndës kontribuan në këtë kurs duke përfshirë psikologun kryesor të sjelljes dhe këshilltarin e NATO-s, Dr Dave Sloggett; Parandalimi i udhëhequr nga Lincolnshire, Leeds dhe Bradford; Lincolnshire Mbrojtja e fëmijëve dhe Bordi i Të rriturve. Kursi bazohet në trajnimin e Parandalimi WRAP dhe është hartuar nga ilustrues specialistë dhe dizajnerë



mësimorë, për të krijuar një kurs interaktiv, që angazhon, me përmbajtje inovative që sjell një eksperiencë efektive dhe ndikuese të të nxënit.

Kursi përfshin karakteristika pioniere si praktika reflektuese, skenarë të bazuar në punë, animacione dhe gjithashtu vjen me një numër burimesh të shkarkueshme.

Ashtu si mësimi elektronik tradicional, kjo përmbajtje ofron njohuri, por më e rëndësishmja, gjithashtu inkurajon profesionistët të marrin në konsideratë se si do ta përdorin këtë njohuri në skenarë të përditshëm për të rritur përvojën e të mësuarit dhe për të rritur mirëkuptimin.

Përmbajtja e këtij kursi është certifikuar në mënyrë të pavarur në përputhje me udhëzimet universale të pranura të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (CPD).

Metoda e zhvillimit: E-learning

Ky kurs mund të arrihet nga çdo pajisje (desktop, laptop dhe tablet) me një lidhje interneti.

Gjatesia e produktit: Përafërsisht 1 - 1.5 orë

Fjalor i termave:

"Ekstremizmi" përkufizohet në strategjinë e Parandalimit 2011, si opozitë vokale ose aktive ndaj vlerave themelore britanike, duke përfshirë demokracinë, sundimin e ligjit, lirinë individuale, respektin e ndërsjellë dhe tolerancën e besimeve dhe bindjeve të ndryshme. Ne gjithashtu përfshijnë në përkufizimin tonë të ekstremizmit thirrjet për vdekjen e anëtarëve të forcave tona të armatosura, qoftë në vend ose jashtë shtetit.

"Ndërhyrje" janë projekte që synojnë të devijojnë njerëzit që po tërhiqen në veprimtari terroriste. Ndërhyrjet mund të përfshijnë mentorimin, këshillimin, mbështetjen teologjike, inkurajimin e angazhimit qytetar, zhvillimin e rrjeteve mbështetëse (strukturat familjare dhe kolegëve) ose ofrimin e shërbimeve kryesore (arsim, punësim, shëndetësi, financë ose strehim).

'Ekstremizmi jo i dhunshëm' është ekstremizmi, siç përcaktohet më sipër, i cili nuk shoqërohet me dhunë.

'Parandalimi' në kontekst të këtij dokumenti nënkupton zvogëlimin ose eliminimin e rrezikut të përfshirjes së individëve në terrorizëm. Parandalimi përfshin, por nuk kufizohet vetëm në



identifikimin dhe referimin e atyre që rrezikojnë të futen në terrorizëm me ndërhyrje të përshtatshme. Këto ndërhyrje synojnë t'i devijojnë njerëzit e prekshëm nga radikalizimi.

“Radikalizimi” i referohet procesit me të cilin një person fillon të mbështesë terrorizmin dhe ideologjitë ekstremiste të lidhura me grupet terroriste.

'Mbrojtja' - Safeguarding është procesi i mbrojtjes së personave të prekshëm, qoftë nga krimi, forma të tjera të abuzimit ose (në kontekst të këtij dokumenti) nga të qenit të tërhequr në veprimtari terroriste. Përcaktimi aktual i Mbretërisë së Bashkuar për **"terrorizmin"** është dhënë në Aktin e Terrorizmit 2000 (TACT 2000). Në përmbledhje kjo përcakton terrorizmin si një veprim që rrezikon ose shkakton dhunë serioze një ose shumë personave; shkakton dëme serioze të pronës; ose ndërhyrje serioze ose prish sistemin elektronik. Përdorimi ose kërcënimi duhet të krijohet për të ndikuar qeverinë ose për të frikësuar publikun dhe bëhet me qëllim të avancimit të një shkakut politik, fetar ose ideologjik.

"Vepra të lidhura me terrorizmin" janë ato vepra (të tilla si vrasja) të cilat nuk janë vepra penale në legjislacionin terrorist, por që gjykohen të kryera në lidhje me terrorizmin.

“Cenueshmëria”- vulnerabiliteti përshkruan gjendjen e të qenit i lehtë të cenohet; i vështirë për t'u mbrojtur; i hapur ndaj sulmit moral apo ideologjik. Në Parandalim, fjala përshkruan faktorët dhe karakteristikat që lidhen me të qenit të cenueshëm ndaj radikalizimit.

© Crown Copyright 2016

Teksti në këtë dokument (me përjashtim të Armës Mbretërore dhe logove të departamenteve ose agjencive të tjera) mund të riprodhohet pa pagesë ose në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në një kontekst mashtrues. Materiali duhet të njihet si autoriteti i kurorës dhe titulli i dokumentit të specifikuar. Ku kemi identifikuar ndonjë material të palës së tretë, ju duhet të merrni leje nga mbajtësit e të drejtave të autorit në fjalë. ISBN: 978-1-78655-061-3